

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përherëshëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

(Adresa, _____ nr. Tel _____, e-mail _____)

Komisioni i Përherëshëm i "Shëndetësisë, mirëqënies sociale, rinisë dhe barazisë gjinore"

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 2 datë 27.03 2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. ____ Datë ____/____/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për: "

- 1/ P/Vendim për miratimin e nd ek nga fondi bashkisë
- 2/ P/Vendim për miratimin e nd. ekonomike 6% për familjet dhe individet.

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore):

Referuar nenit 21 të Ligjit Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 597 datë 04.09.2019 " Përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" etj...

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit):

Aktualisht po trajtohen 43 familje/individë nga fondi i deleguar nga buxheti i bashkisë Gjirokastrë dhe 7 individë/familje nga fondi i kushtëzuar deri në 6% mbi bllok ndihmën ekonomike duke mundësuar suport ekonomik për një periudhë të pacaktuar për të gjithë individët/familjet që nuk rezultojnë përfitues nga aplikimi në Sistemin Elektronik të Pikëzimit, por në bazë të plotësimit të kriterëve të miratuara nga Këshilli Bashkiak cdo fillim viti, rezultojnë përfitues. Vlerësimi bëhet në bazë të vetdeklarimit dhe situatës reale të evidentuar në banesën nga administratori shoqëror.

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet) :

Përsa i përket vitit që lamë pas fondi i deleguar nga buxheti i bashkisë arrin në vlerën 1,800,000 lekë/vit. Viti 2024 ishte viti i parë, në të cilin u delegua shpërblim edhe për përfituesit nga fondi i vendor në vlerën 210,000 lekë.

Për vitin 2025 ky fond arrin në vlerën 2,000,000 lekë/vit ose 166,666 lekë/muaj. Kjo është vlera e fondit e përllogaritur aktualisht, në varësi të individëve/familjeve që do të jenë përfituese, mund të vlerësohet nëse do të ketë shtesa ose pakësime në buxhet.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Agjencia e Shërbimit Social, specifikisht Zyra e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Shoqërore.

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh: Monitoron komisioni i “Shendetesise, mirëqënies sociale, rinisë dhe barazise gjinore”, dhe keshilli bashkiak cdo muaj dhe sa here sheh ai të nevojshme

Impakti social / grupet që preken:

- Sikurse është sipërpërmendur, përfitues janë kategoritë e paprivileguara nga sistemi i pikëzimit, të cilat paraqesin problematika social-ekonomike sic mund të jenë; familje të cilat sigurojnë të ardhura të pamjaftueshme dhe në përbërje të tyre kanë të mitur, Vajza/gra kryefamiljare të divorcuara/të veja me fëmijë në ngarkim, kryefamiljar që me vendim gjykatë kanë në ngarkim fëmijë të mitur, Familje me më shumë se 4 (katër) anëtarë ku në përbërje të tyre kanë të paktën 3 të mitur, familje të cilat kanë në përbërje të tyre persona me pagesë paaftësie, status verbërie/para-tetraplegjisë/ status invalid pune, familje me 1 ose 2 anëtarë të moshës mbi 50 vjeç, të cilët janë në pamundësi punësimi nga strukturat shtetërore mbështetëse, të pamundur për punë për arsye shëndetsore apo moshe, familje me një anëtarë mbi moshë pune që nuk përfitojnë pension pleqërie...etj në varësi të rastit të paraqitur.

A është objekt i konsultimit Publik: Jo

Komisioni i Përhershëm për " Shëndetësisë, mirëqënies sociale, rinisë dhe barazise gjinore", i mbledhur me datën 27.03 2025, shqyrtoi projekt vendimit nr. _____ datë _____ 2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "për ndihmën e ekonomike / fondi i bashkisë"
fondi 6%

" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni e me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- ☒ a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- ☒ b) miratimin e projektaktit
- ☒ c) refuzimin e miratimit të projektaktit
- ☒ d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:
 - ☒ Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në "-----"
 - ☒ Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në "-----"
 - ☒ Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në "-----"
 - ☒ Paragrafi 15 (pesëmbëdhjetë) i projekt vendimit të ndryshoje në "-----"

Bashkëlidhur argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Anila Lacaq Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)
Ledian Pondo Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Datë 27.03 2025